ADEM ZAPLLUZHA

FLUTUROJNË ZOGJTË E VERBËR

Redaktor:
Xhevahir Cirongu

Recensent:
Mazllum Baraliu

Lektor:
Xhevahir Cirongu

ADEM ZAPLLUZHA

FLUTUROJNË ZOGJTË E VERBËR

"TREND"
2015

FJALA E REDAKTORIT

Poezi fosforeshente me rrënjë fjale që lind nga kocka e poetit

Të shkruash diçka për poetin Kosovar Adem Zaplluzha, në radhë të parë duhet që të kalosh nëpër filtrin e mendimit e të fjalës së shkruar prej tij. Çdo fjalë e rresht që ka shkruar në libra me poezi Ademi, sigurisht ai e ka ‘’matur e peshuar’’ mirë brenda vetes mendimin e fjalës, pastaj e shkruan në letër. Ai gjurmon si skifter mes skutave të fshehta të mendimeve dhe i perin ato brenda shpirtit. Pastaj, si një hekurpunues dredh ujëvarën e shpirtit në letër. Me krijimet e tija, poeti Adem Zaplluzha ka formuar ‘’liqenin’’ e vet me fjalën e bukur shqipe. Unë do ta quaja këtë poet, si një poet i shekullit të ri të 21-të, sepse kush si ai s’ka krijuar e botuar kaq libra me poezi,(ka edhe botime të tjera përveç poezisë). Ai dallohet për varg ‘’Naimian’’, ‘’Çajupian’’ ,’’Migjenian’’ etj.

Pse e quajmë kështu këtë poet?!

Po të hedhim një vështrim në gjithë krijimtarinë e tija në konceptin kohë, por e në pozicionet konceptuale të lëvrimit krijues letrar; do vijëzosh trekëndëshin e tre kohëve: 1. Të djeshmen krijuese

në kushtet e një regjimi totalitar e skllavërues. 2. Atdhedashiria për vendlindje e gjuhën shqipe. 3. Krijimtari në moshë të re, si dhe moshën e thyer të sotme nga vitet e jetë me rrënjë te liria e Kosovës, po ashtu edhe të fjalës së shkruar shqipe. Poeti bën një përshkrim faktik historik e letrar të të gjithave ngjarjeve të popullit ku ka lindur edhe vetë ai, madje është edhe pjesëmarrës direkt në këtë rrugëtim sa të vështirë e plotë madhështi me çlirimin e Kosovës nga okupatori shekullor Serb. Drithërima e shpirtit të poetit Adem Zaplluzha, lakonte dhe lëngonte për shtypjen mizore që bënte **''korbi i zi''** sllav edhe në fushën krijuese për gjithë shkrimtarët e poetët në Kosovë, e sidomos ndaj atyre me prirje atdhedashuri për fjalën e shkruar shqipe. Poeti ka ditur të kapërcejë me zgjuarsi dhe krijimtari letrare çdo sfidë të kohës makabre. Ai merr guximin e hedh në letër mendimet e tija, nga ku poezia ishte arma e vetme por edhe më e fuqishme që ngrinte peshë ndjenjat e popullit të vet , e që mbillte me vargun e poezisë lulet e lirisë në Kosovën martire. Mbas çlirimit të Kosovës, këto lule u rizgjuan brenda shpirtit të poetit dhe shpërthejnë si yje në qiell të kaltër, sepse ato kishin kohë që qëndronin të ''fshehura'' në qenien e tij, e si rrjedhim udhëtuan me emrin liri drejt vargut poetik e vëllimeve të 116-të. Poezitë e Ademit janë të thjeshta në dukje për lexuesin dhe për çdo lexues të thjeshtë. Kanë një rrjedhshmëri të pastër kur lexon, por aty do ndjesh një krenari të ligjshme e hyjnore

që të ndez zjarre dashurie për njerëzit, atdheun, traditat e popullit shqiptar, fjalën e bukur shqipe, pulson jetën tonë në vargjet e poezisë.

Takon personalisht poetin e befasohesh për fjalën e ëmbël që derdh nga shpirti me një dashamirësi që është tërësisht njerëzore.

E si mund të mos krenohesh për këtë njeri, sa njeri po aq edhe poet!?

Ecën me kohën, ka shkelur mbi kohëra të zymta e të trishtë, por kurrë s'është përkulur para vështirësive. Ai ka thyer çdo gur të zi që i ka dalë para, pra, me simbolin e fuqishëm si një mal alpin ngarkuar me borë, por gur zjarri brenda shpirtit të derdhur me aq dashuri në letra fjalën shqipe. Edhe libri i fundit që pret botimin të titulluar **''Fluturojnë zogjtë e verbër''** , na jep plot figura letrare dhe forcën e shprehjes filozofike të vargut poetik. Te poezia me titull **''Ta ndjejmë ekzistencën e fjalës''** aty gjallojnë të fuqishme figurat letrare. Poeti është treguar i kujdesshëm jo vetëm te ky vëllim, por edhe në treguesit e përmbajtjeve të titujve dhe të brendisë që kanë gjithë vëllimet e botuara të mëparshme. Ai asnjëherë se ka përsëritur vetveten në poezitë. Të gjitha janë të ndryshme e dallohen lehtë nga vëllimi në vëllim,por edhe nga poezia te poezia. Ne shkëputëm për ilustrim këto strofa nga poezia **''Ta ndjejmë ekzistencën e fjalës''.** Autori e barazvlerëson fjalën e shkruar me peshën e gurit,

me dritën e yjeve, me ngrohtësinë e rrezeve të diellit, por edhe të larë me vesën e mëngjeseve. Fjala është ajo që të ngroh më shumë se zjarri ,- thotë poeti Adem Zaplluzha. Por kur ajo është e gatuar me baltën e vendlindjes. Poezia e poetit Kosovar Adem Zaplluzha ka dritë fosforeshente me rrënjë burimore që del nga kocka e trupit të vetë poetit. E si e tillë ajo duhet vlerësuar nga qarqet akademike e filozofike historike , letrare e gjuhësore mbarëkombëtare.

'' Sa herë që deshën të parët e mi
Nëpër xhepat e erës,
E gjetën vetveten.
Thonë se kur nuk kishin grurë
Në copa rrasash gatuanin dashurinë.

Kështu mësuam nga gjyshërit
Ta ndjejmë ekzistencën e fjalës,
Nuk ishte aq lehtë
Të kapërcehet përtej vetvetes.

(…………)

Nuk na u deshtë shumë kohë
Mësuam shpejt,
Dhe nga ne mësuan të tjerët
Se si ruhet dhe ndizet zjarri''.

Vet poeti është dashuruar pas letrave. Të shkruash një letër nuk është aq e thjesht sa thuhet. Letra është e bardhë në formën e saj ku mbi atë shkruhet me penë e që derdhet boja që formojnë shkronjën e më pas fjalën. Kur lexohet dëgjojmë tingullin e saj, ëmbëlsinë, dashuri fjale që pasqyron botën e atij që e shkruan.

Po vetë poeti ku është në këtë rast?

Ai është si një margaritar i gjithëgjendur te fjala e vargu i shkruar në letër. A s'është fakti që ky poet me një moshë mbi 70 vite mbi supe, shkruan e krijon mbi tastierën e kompjuterit , që i cili fal energji krijuese për poezinë e dashamirësit e letrave shqipe kaq botime!?

Në poezinë e titulluar **''Të lutem më shkruaj një letër''** ai shprehet qartë dhe me një ekuivalencë të fuqishme letrare. Rryma e të shkruarit, metafora e krahasimet që përdor poeti janë të mbështetura edhe te poetët e tjerë shqiptarë, si te vargu i Naimit, Çajupit, Migjenit etj.

Dhe më konkretisht:

''Më shkruaj një letër
Ku nuk dëgjohet britma e Ot'hellos;
Le të jetë me ngjyrë menekshеje
Po me atë ngjyrë
Që i përngjan dashurisë tënde''.

Poetët nuk i tremben vdekjes. Ata e shohin si një pjesë të vazhdimit të jetës. E pse t'i trembemi vdekjes, -thotë poeti në një poezi?! Të jetosh jetë, duhet që të bësh diçka të dobishme në këtë botë, jo vetëm për veten por e për të tjerët, për gjithë shoqërinë, pra kështu s'ka edhe vdekje, por s'ke edhe frikë nga kjo vdekje që dikur ajo do na trokas në pragun e jetës sonë. Atëherë, pse të kemi frikë nga kjo vdekje?

Ta konkretizojmë me disa rreshta që poeti ka shkruar te ajo poezi ku thotë se, **''s'duhet të vdes kurrë!'' .**

''Vdekja nuk është vdekje
Po që se ke kohë,
Të rrëfehesh
Përpara pasqyrës se mendjes tënde.
(……)

Për të mos vdekur askurrë
Mbille pemën tënde,
Të shenjtë mbille
Në rrëfyestoren e shpirtit''.

Te poezia e poetit Kosovar Adem Zaplluzha gjen vetveten, gjen forcën e mendimit, aty rrjedh e kristaltë fjale e shkruar me petalet e luleve shumëngjyrëshe, tingëllon si valë deti mendimi, vargu merr freskinë e erës së malit e gatuhet me

brumin e pjalmit të pemëve, dëgjohen cicërima zogjsh në fluturim, e mbi të gjitha ka dashuri njerëzore me rrënjë te atdheu, te vendlindja,poezi fosforeshente me rrënjë te kocka e vetë poetit. A na lejohet të themi se: Poetët s'kanë vdekje?! Gjykimin bëheni vetë ju lexues nëse kemi të drejtë apo jo për këto fjalë zemre që po themi për poetin Kosovar.

Xhevahir Cirongu, publicist,poet, shkrimtar
Durrës, Gusht 2014.

Fluturojnë zogjtë e verbër
Cikli i parë

DIMRI SIVJET ISHTE TEPËR I ACARTË

Nga degët e brymta të mjegullave.
Për çdo ditë e më shumë,
Dimri po i shkelë rrugët tona.

Po shkojnë zogjtë?
Një ditë do mbesim
Si drurët e vetmuar në mal.
Vetëm erërat mund të fshihen
Nëpër zgërbonja lisash të tharë.

Dimri sivjet ishte tepër i acartë
Një murrlan i çmendur;
I shkuli trungjet e lisave
Shkundi edhe gurtë
Nëpër brigjet e durimit njerëzor.

Po shkojnë, na ikën miqtë
Ndoshta tani janë diku larg,
Nëpër udhët e përtejmes
Nuk metën as qyqet e zeza
Një nga një po na largohen zogjtë.

TA NDJEJMË EKZISTENCËN E FJALËS

Sa herë që deshën të parët e mi
Nëpër xhepat e erës,
E gjetën vetveten.
Thonë se kur nuk kishin grurë
Në copa rrasash gatuanin dashurinë.

Kështu mësuam nga gjyshërit
Ta ndjejmë ekzistencën e fjalës,
Nuk ishte aq lehtë
Të kapërcehet përtej vetvetes.

Por ne e bëmë të pamundurën
Dhe arritëm majat e yjeve,
Mbërrimë deri atje
Ku rriten gurtë e kristaltë.

Nuk na u deshtë shumë kohë
Mësuam shpejt,
Dhe nga ne mësuan të tjerët
Se si rruhet dhe ndizet zjarri.

Pak ishim më ndryshe
Nuk di as vetë se si ishim,
Por të tjerët na pagëzuan barbar.

2.

Nuk ishte koha e mbylljes së dyerve,
Sepse ata që mbyllen
Janë të gjykuar.
Të mos e shohin kurrë dritën!

Ne pakëz tepruam me mirësinë tonë
I hapëm edhe dritaret,
Pa menduar
Se ujqërve u mjafton
Vetëm një plasaritje e murit.

KËTO MOTRA BINJAKE TË LËVIZJEVE

Ecjet janë të çuditshme
Dinë se ku dhe kur mbërrin,
Sa mbyll e çel sytë
Arrin cakun e duhur.

As kur bie shi nuk ndalen
Një lëvizje e paimagjinueshme,
Kalon prej një ane të rrugës
Deri në anën tjetër të mendimeve.

Njerëzit dhe gjërat lëvizin si hijet
Nuk ndalen askurrë,
Edhe nëse i mbërrin caqet e të mundshmes
Sërish vazhdon
Po ajo lëvizje në vetvete.

Kështu i kanë ecjet
Këto motra binjake të lëvizjeve,
Ecin e nuk ndalen kurrë.
Edhe kur mbërrin në cak
Sërish rifillojnë një ecje tjetër.

SONTE PO BËNË SHUMË ACAR

Jemi shumë larg njëri-tjetrit,
Kurse duart e mia
Edhe më larg.
Vetëm një shkrepje syri më mjafton
Që t'i zë në ikje e sipër çastet e humbura.

Sonte po bënë shumë acar,
Kjo pranverë po ma mërdhin gjakun.
Kur ishe ti me mua
Dimri ishte shumë më i mirë,
Mes nesh qëndronte ngrohtësia e dhomës.

Tani jemi me qindra vite larg
Udhët deri te ti moj mike,
Nuk duken askund..!
Më duket se që të dy ne në këto çaste
Kemi mbetur pa ëndrra.

Ku je në cilat porta të trokas?
Këtu në këtë metropol
Gjithmonë janë të mbyllura dyert.
Njerëzit janë të ftohtë
Përngjajnë me kallkanët
E dimrave të acartë të Ballkanit.

TË LUTEM MË SHKRUAJ NJË LETËR

Më shkruaj një letër
Të thjeshtë njerëzore,
Letra e cila lexohet
Me shpirt dhe zemër.
Nuk më duhen pikëpyetjet
As pikë çuditëset e çmendura.

Më shkruaj një letër
Ku nuk dëgjohet britma e Othellos;
Le të jetë me ngjyrë meneksheje
Po me atë ngjyrë
Që i përngjan dashurisë tënde.

Nuk më pengojnë aspak
Gabimet e tua ortografike,
Unë kam nevojë për fjalët që ledhatojnë
Pika dhe pikëpresja shpejtë zhduken
Kur fjalët maten me zemër.

Thonë se presja e ka shpëtuar kokën
E një të dënuarit;
Ama, ne nuk jemi mbretër satrapë
Që të japim urdhra
Ose të pranojmë pekule.

Thjesht jemi njerëz,
Që jetojmë prej një gabimi në tjetrin.
Të lutem!
Më shkruaj një letër,
Por jo me pikëpyetje
Veç me zemrën tënde të brishtë.

KUR TË PUSHOJNË TË RESHURAT

Diçka nuk është në rregull me të reshurat
Po bien shirat e kaltër...!
Po bien edhe stinët
Si flokët e të moshuarve
Qime pas qimes po këputen ditët.

Një fjalë prej tunxhi
Më lëshohet mbi kokë,
Dikush sërish i hapi portat e shirave.
E ata nuk mejnë me orë të tëra
Po bien si zogjtë e trentë
Në përparësen e agimit.

Jam lodhur pak si shumë
Po më ngufat frymëmarrja,
Këto gjethe të zverdhura po ikin sonte
Si zogjtë shtegtarë po largohen
Nëpër kujtimet e brishta të mjegullave.

Vetëm edhe sonte duhet
Ta durojmë stoikisht,
Këtë kakofoni mbi ullukët e vjetër
Nesër në mëngjes shohim e bëjmë.
Kur të pushojnë të reshurat
Do i lëshojmë mëllenjat të fluturojnë
Hapësirës së paanë të qiellit.

PËRTEJ GJELBËRIMIT TË BREGUT

Pas pak çasteve dita e sotme
S'do të jetë më sot,
Por një tjetër ditë
Do ikën në një tjetër kohë
Si sandalet e njeriut që i shkelte detet.

As ti e as të tjerët tok me mua
S'do kemi kohë,
Ta përjetojmë fundosjen e ditës
Në gotën e dehur të kafenesë
Po ngjan përmbytja e madhe.

Prej asaj ane të përgjumur të detit
Ishujt po na shikojnë në një mënyrë habitore;
Mbrëmë aq shumë hingëlloi
Rrjeta e peshkatarëve
Sa që meduzat e kaltra i zuri paniku.

Vetëm zëri i një varke të vetmuar
Dëgjohet si vaji i detit,
Dënesnin edhe dallgët në damarët e kripës
Përtej gjelbërimit të bregut.
Etja ishte e madhe
Sa që i kafshonte kokrrat e brishta të kripës.

JASHTË PO FRYNË NJË ACAR I ZI

Për çudi
Sonte dëgjohet gjëma,
Në dhomën time me dritare
Pa xhama!

Një mur i djersitur
Si ujku i tërbuar,
E ka hapur gojën dhe gjoksin
Don të më përpijë si dritaret e dehura.

Jashtë po fryn një acar i zi
Një shi monoton,
S'ka gjasa të ndalet në këto çaste.

Deri në tokë
Kanë zbritur mjegullat,
Edhe sivjet
Do kemi punë me shpendët grabitqarë.

HAPEN EDHE DYERT E MBYLLURA

Ngjarjet ndodhin si nëpër filma
Me skenar të imagjinuar,
Ndodhin dhe ringjallen pas prapaskenave
Një mbret abdikon
Kurse tjetri i mpreh dhëmbët.

Si nga përrallat biblike
Dalin në shesh merimangat
Me rrjeta të thurura;
Para qindra vjetëve
Dalin në shesh lëndinave
Personazhet e mendjeve të sëmura
Dhe bredhin rrugëve qorre si kardinalët.

Në qytetin tim ka pakëz hije
E më shumë fjalë.
Qepenat e dyqaneve rrapëllojnë e kërcasin
Hapen edhe dyert e mbyllura
Me dryna të rëndë,
Lagja pakëz më ndryshe
Sot po e ndjen frymëmarrjen e së nesërmes.

NJËHERË NË MAJE TË NJË PLEPI

Ne patëm shumë ëndrra në jetë
I pamë gjërat,
Ashtu siç na pëlqente vetëm neve.

Ditët tona i përngjanin stuhive,
Kurse netët
Mbetën pa kurrfarë emri.

Njëherë në maje të plepit
Mbollëm një pemë
Lulet çelën mes dy stinëve.

Askush nuk e dallonte më
Se kur ishte dimër
E kur vapa shkrinte gurin.

Pema vinte duke lulëzuar
Disa lloje lulesh,
Nëpër lagje të vetmuara galopuan degët.

Kur papritmas një ditë ato lloje të luleve
U shndërruan në lisa,
Dhe në fund të vrapit stinët i zhdukën!

PËR NJË VRAP TË TILLË

Më kujtohet kur më thoshte im at'
Biro! Vrapo pas ëndrrave tua
Vrapo...
Nëse ndalesh në rrugëtimin tënd
Të zihet fryma.

Për një vrap të tillë
Nuk ke nevojë për rregulla gramatikore;
Nuk të duhen thonjëzat
Me i tregua gënjeshtrat e erës,
As pikëpyetjet e furtunave
Të gjithë ne u besojmë ëndrrave.

Njeriu veç duhet me i zgjatë duart
Dhe ja ato vijnë vetë,
Vijnë pa i njohur rregullat e mirësjelljes
Ti vetëm pritë derisa hëna i përngjan
Draprit ose pjeprit të pjekur në bostanishte
Me tërë aromën e fushës do e ndjen ëndrrën.

Prishtinë, 24 qershor 2014

EDHE TË DIELËN NË ORA SHTATË

Pikërisht është ora shtatë e mëngjesit
Koha kur zgjohen ëndrrat tona,
Edhe sot na thanë meteorologët
Se do jetë një mot i ndryshueshëm
Me pak diell e me më shumë shi.

Me muaj nuk po ndryshojnë ditët
Aq shumë pat të reshura sivjet,
Saqë po kalben
Rrënjët e zverdhura të barishteve
Më duket se shirat e tepruan me këta lot.

Akoma nuk ndalen
Po bien edhe meteorët,
Një nga një po bien ëndrrat
Po fundosen në harresë si perëndit e Olimpit
Çfarë të bëjë me duart e mia?!

Edhe të dielën në ora shtatë
Ky shi i mërzitshëm,
Po e shqetëson kambanën
Asnjë pëllumb i bardhë nuk zbriti
Në ëndrrën e ringjallur të kambanores.

RRINË ULUR PERËNDITË PAGANË

Fare pa nguruar i them dimrit
Bëhu pranverë,
Se vetëm atëherë
Eshtrat e mi të lodhur lulëzojnë
Shpirtin e bardhë të zambakëve.

Ky qytet i im antik
Në çdo stinë të ardhur këtu,
Luan një pjesë teatrale nga lashtësia
Në panteonin e mendjes
Rrinë ulur perënditë pagan.

Këtu ka njerëz me shumë dëshira
Dikush i do dimrat e acartë
Kallkanët i ka vëllezër prej gjaku
Kurse për stinët e tjera
Askurrë nuk e qanë kokën

Lumëbardhi është përherë i përgjumur
Ka aq shumë sklepa nëpër sy,
Saqë kur e zgjon këndesi
I lagjes së Kojrrilave
Me orë të tëra kacafytet me pasqyrën.

BËJNË DASMË NETËVE TË VONA

Në brendinë e thellë të një shporte
Me dredhëza
Rrinë edhe mendimet.
Rrinë si thellësitë e rrënjëve
Të luleshpatës,
Mjegullat e zeza dorë për dore
Zbresin me shirat idhnak.

Zbresin mbi ullukët e çative
Të vetmuara,
Nëpër ato kulme
Ku asnjeri nuk banon.
Vetëm lakuriqët e natës
Bëjnë dasmë netëve të vona.

Edhe erërat vijnë këndej pari
Vijnë dhe i shkulin pemët,
Nëpër kajsishte
Dhe në fund të fshatit
Ulen me barinjtë
E llafosen për motet e liga.

Më kujtohet
Kur erdhën të huajt,
Njerëz që nuk i ngjanin njerëzve.
E kishin aq të madhe lakminë,
Saqë çdo leckë e lënë
Mbi gardhet e arave tona sa ora zhdukej.

E MOS ARDHSHIN MË ASNJËHERË

Tani më nuk më kujtohet
Ata që erdhën dje,
A thua vallë ishin njerëz
Ose hije të tejdukshme
Të hijeve të tyre morbide.

Por, ata erdhën,
E mos ardhshin më asnjëherë!
Nuk ishin as njerëz
E as hije të tejdukshme,
Ishin disa krijesa asnjanëse
Pa kurrfarë yndyre.

Erdhën nga disa maja të çmendura
Ia behën me një kryq qesharak:
Dukeshin si gogol fushe
Me ato opinga prej druri,
Për nga ndjenjat njerëzore
Përngjanin me drurët e dimrave të acarta.

BËHU I URTË BIRI IM

Bëhu i urtë biri im
Aq i urtë,
Sa që mund ta kalosh lumin
Pa i lagur këmbët.

Zgjati duart deri te parzma e erës
Përqafoje vetminë e qiellit,
Pastaj zbrit në tokë
Dhe bisedo
Me shushurimën e gjetheve.

Urtia nuk është në moshë
E as në kokë,
Ajo fitohet duke gjurmuar
Nëpër shpirtra të njerëzve
Dhe nëpër libra të vjetër.

Bëhu i urtë biri im!
Saqë nga urtësia e jote
Të mos lindin vetëm fjalët,
Por malet dhe drurët
Që ecin kah e nesërmja.

PËR TË MOS VDEKUR ASKURRË

Vdekja nuk është vdekje
Po që se ke kohë,
Të rrëfehesh
Përpara pasqyrës se mendjes tënde.

Hidhe shikimin e mendimit
Prapa shpine...,
Dhe shiko se sa herë
E ujite pemën e mbjellë.

Në jetë çdo gjë vdes
Ashtu siç ka lindur,
Si druri lakuriq
Vdes në një ëndërr të vetme.

Për të mos vdekur askurrë
Mbille pemën tënde,
Të shenjtë mbille
Në rrëfyestoren e shpirtit.

FLUTURIMET E ZOGJVE TË HEKURT

Të kam parë se si i pikturoje lulet
Në fustanin tënd të kuq,
I pikturoje
Ashtu siç i pikturonte murrlani
Gjethet e zverdhura të një vjeshte.

Nuk di cila stinë ishte pranë teje
Pranvera e hershme,
Ose dimri i vonshëm
Mbase që të dyja stinët
E kishin zënë ngushtë njëra-tjetrën.

Binte një borë e çuditshme
Nuk ishte as e bardhë e as e verdhë;
Bora me ngjyrë asnjanëse
Ethshëm trokite
Nëpër eshtrat e thyer të kohës.

Ne ishim në pritje e sipër
Prisnin fluturimet e avionëve të shpresës.
Qielli ishte tejet i ngrysur
Por kurrsesi të ndalen,
E si mund të ndaleshin gëzimet e çative
Që i pritnin me padurim
Fluturimet e zogjve të hekurt.

AQ SHUMË NDRIÇOJNË SYTË E TU

Nuk dua që sonte askush
Të troket në derën time,
As era nuk guxon të rrapëlloj
Çmendurisht
Ashtu siç rrapëllonte herëve të tjera.

Kjo natë vetëm neve na përket
Nëse troket era,
Do ja thyej të dy brirët
Sonte vetëm unë e ti.
E dashur,
E kemi në dispozicion këtë natë!

Nuk kemi nevojë për asnjë trekëndësh
Asgjë nuk na duhet,
Përveç dritës së zbehtë të hënës.
Asgjë tjetër,
Aq shumë ndriçojnë sytë e tu
Sa që po e shndrinë tërë dynjanë.

FLUTUROJNË ZOGJTË E VERBËR

Këtu te ne netët
Si të çmendura këlthasin;
Qiellit të mjegulluar
Fluturojnë zogjtë e verbër.
Nuk ndalen as ulërimat e ujqërve
Me shekuj ishim të huaj,
Nëpër vatrat tona
E netëve të vona zhdukeshim si hijet.

Kurse mëngjeseve herët
Kur na zgjonin këndesat,
Ne veç kishim nisur të plakemi
Na lodhnin deri në alivanosje.
Zërat e shthurura të korbave apokaliptik
Mbi çatitë e dergjura
Nuk fluturonin më pëllumbat.

Megjithatë nuk u ndalëm asnjëherë
Në kthetrat e kohës,
Kërkonim dritën e shpëtimit.
Ishim ndoshta të parët
Që i besuam dritës,
Një tunel i largët diku përtej mendjes
Na prite me një kandil të ndezur.

DHE U RRITËM SI LISAT NË STUHI

Na u rreshkë lëkura e regjur
Në vend të jastëkut
Shtronim gurë,
Si lisat u rritëm në stuhi
Diellin e patëm sa afër
Po aq edhe larg atdheut.

Kur ktheheshim në vatër
Ktheheshim
Mbështetur për kondakun e thyer.
Nuk ishim më për asnjë punë
Nëpër llogore trishtimesh
I lëmë peng gjymtyrët.

Ishim ushtarë,
As vetë më nuk dimë se të kujt
Prej një lufte
Shkonim në një tjetër luftë.
Të huajve u dhamë gjeneral e kardinal
Kurse ne mbetëm
Si fakir sokakëve të dynjasë.

Nëpër dynja shërbyem
Si ushtarë të grekut dhe të turkut;
Bëmë roje nderi
Për kufoma bastardësh
Dhe u rritëm si lisat në stuhi
Duke i lënë eshtrat
Për ata
Që na i vrisnin fëmijët.

Nëpër xhamat e kujtesës
Cikli i dytë

VERIU DOLI NGA BINARËT E VERBËR

Njeriu përherë ndjen
Se dikush i huaj përdhunshëm,
Banon në shpirtin e tij
Sa herë që troket shiu në xhamat e kujtesës
Pranvera zgjohet nga gjumi dimëror.

I tërë qyteti duket disi pak më ndryshe
Se vendlindja e Uliksit;
Vetëm qentë endacak
I njohin huqet e banorët e vjetër
Kurse dimrat egër
Në çdo kohë i ndërrojnë gëzofët.

Nuk di se çfarë stine ishte dje
Por sot nëpër zgërbonja lisash,
Po fërshëllen si e çmendur vjeshta
Veriu doli nga binarët e verbër
Itineraret e trenave pësuan metamorfozë.

LUMI NË EKSTAZË I KISHTE PËRPIRË

Era mbrëmë artikulonte
Disa zëra të panjohura deri më sot,
Të cilit dukeshin
Si zërat e largëta të jashtëtokësorëve.

Si deti i verbër uturinte qielli
Një mal gjigand kishte rënë në dy gjunjë;
Dhe i vajtonte me ngashërim
Fatet deveve të ngordhura
Shiu i egër nuk prante mbi çatitë.

Dikur vonë pas mesnatës,
Kur filluan të na mungonin shpresat
Mes kolonadave
I dëgjuam të lehurat e yjeve.
S'pushonin as meteorët me bisht
Një toreador në arenë
Aktin e parë e përfundoi me vetëvrasje.

Era mbrëmë pa dashje gjendej
Në anën tjetër të rrugës dhe dëneste,
Askush nuk vinte këndej
Ama as nuk kishte
Se si të kaloj andej urës
Lumi në ekstazë i kishte përpirë
Të gjitha urat e drunjta të Lumëbardhit.

TË ÇARAT E NGRIRA I SHTRINË DUART

Nëpër muret e ngrira
Dhe të çara,
Vetëm data hyrjesh
Kurse daljet në të shumtën e rasteve
Ngecin të ngrira në ajër.

Dora e prerë
S'mund të shkruaj më asnjë datë;
Daljet janë të pamundshme
Vetëm arkivolet kapërcejnë
Korridoreve të ngushta kokulur
Dhe nuk bëzajnë asnjë fjalë.

Nëpër ato dhoma ku nuk shënohen
Datat e daljeve
Disi ka një zbrazëti të tunxhtë.
Të çarat e ngrira i shtrinë duart
I shtrinë kah zbrazëtit e shurdhëta.

Këtu në këto dhoma të akullta
Mund të hyj njeriu në çdo kohë,
Kurse daljet janë si mallkimet
Asnjë derë nuk ekziston këndej pari
Nga e cila mund të del njeriu
I shëndosh prej mendjes nga ky trishtim.

PREJ TË BURGOSURVE ANONIM

Më thënë këtu nuk ka
Dhoma të sheshta,
Nëse hyn
Mos kërko të dalësh jashtë.

Nga këto dritare të akullta
Fluturojnë vetëm copëra qivuresh,
Të gdhendur
Prej të burgosurve anonim.

Ka raste kur mund të dalin
Vetëm bubuzhelët,
Dhe minjtë e gjirizeve
Por njerëzit asnjëherë nuk dolën.

Këtu je i sigurt
Më thënë..!
Asgjë nuk del nga këto porta
As zëri kryengritës i njeriut.

LOJA

Sapo përfundon një lojë
Fillon tjetra
Një njeri i vogël lind,
Kurse i madhi përfundon
Në ingranazhet e përditshmërisë.

Nëse në lindje bie shi
Në perëndimin e egër
Era i shkulë nga rrënja kaktuset,
Zëri i shkretëtirës mbytet
Mes dy intervaleve të erës.

Kurse në jugun e ngrohtë
Koralet lozin një valle të vjetër ballkanike;
Nuk ndalen as perënditë pagan
Lozin njerëzit dhe erërat
Vallen e vjetër nëpër teatrot e Olimpit.

Prishtinë,25 qershor 2014

MBANTE NËN SQETULL HIJEN E VDEKJES

Në hapësirën e përhirtë
Galopojnë katër kuaj të padukshëm;
Nga shpirti i mykur i gjetheve
Frynë një erë e kalbur dhe kundërmuese.

Nëpër rrugët e qytetit fantazmë
Megjithatë kalërojnë,
Çmendurisht galopojnë
Katër hije të zeza
Të kalorësve të ngurtë.

Dita e sotme për çudi
Paska një shije të hidhur pelini,
Nga të katër anët e botës
Duken se janë çmendur erërat.

Lagjet qenkan strukur në vetvete,
Dhe rrinë të turpëruara
Nëpër të çarat e mureve
Dalin merimangat e zeza.

Si nga dheu i zi
Mbi një kalë të bardhë,
Një hije e zezë morbide
Sheshazi galopon rrugëve.

2.

Njerëzit e stepur dhe të ngrirë
Shikojnë imazhet,
Që mbinë nga lagështia e tokës
Furtuna lëshoi në ajër shigjetën e parë.

Nëpër tym të ndotur
Si do hije morbide
Mbetën vragat e dhembjes.

Posa e ktheva kokën
Një tjetër kalorës
Me një shpatë të zjarrtë
Shkelte mbi urën e kalldrëmtë.

Lumi i ndryshkur kollitej si mali
Nga një galop i paparë,
Nga shpirti i lashtësisë
Shkuleshin kalldrëmet.

Mu ashtu siç thonë legjendat
U hap parzma e tokës,
Mbiu një tjetër kalorësi
Edhe më i zi se sterra.

3.

Po ai kalorës i zi
Mbante në dorën e djathtë
Peshoren e trishtimit.
Era e shkulur nga degët e rrapit
I mate dhembjet e pamatura deri më sot.

I katërti kalorës
Mbante nën sqetull
Hjen e vdekjes së ditës
Dhe galoponte rrugëve qorre.

Si nëpër disa ëndrra të verbëta
Në kolona të zgjatura,
Rrëshqite bishti i gjarprit me zile
Nuk ndaleshin imazhet e zvarranikëve.

Turma njerëzish të frikësuar
Pritnin kalorësin e pestë!

SA QË NË PASQYRE NUK E NJOHIN VETVETEN

Vonë kuptova
Se në fshatin tim si shpresat
Rriten drurët melankolik;
Edhe gjelbërimin e përfshin
Një lloj ekstaze
Që mbinë vetëm në vendin tonë.

Lulet nuk ngjajnë me ato lule
Që rriten fushave,
Ose nëpër saksi artificiale
Çdo gjë këtu mbinë
Nga shpirti i virgjër i tokës.

Edhe njerëzit janë të tillë
Sa shumë ngjajnë
Me njëri-tjetrin,
Kur i humbin kapelat
Sa që në pasqyre nuk e njohin vetveten.

Secili prej tyre
Mbanë nga një lule të verbër në dorë;
Ngopen vetëm me aromë bari
Kurse në vjeshtën e vonë
Kur i shkundin frytet
I përngjajnë dimrit që pret te malet.

NGJAJNË ME LEJLEKËT E BARDHË

Stinët në qytetin tim
Janë të zbrazëta si njerëzit,
Pa kurrfarë logjike
Bredhin rrugëve të vetmuara.

Bredhin me nga një qese plastike
Në dorën e majtë,
Kurse të djathtën e konsiderojnë
Kinse është dora e shenjtë.

Jetojnë ose më mirë me thënë,
Bashkëjetojnë
Me disa doke të vjetra pagane
Ngjajnë me zogjtë shtegtarë.

Asnjëherë nuk i mbathin
Që të dy këpucët,
I shohim shëtitoreve
Me një këpucë të kaltër dhe blu.

Kanë disa doke të përçudnuara
Kur ndalen të pushojnë,
Ngjajnë me lejlekët e bardhë
Qëndrojnë vetëm në njërën këmbë.

SËRISH NUK NDALEN ERËRAT

Njerëzit nuk më kuptojnë
Askush nuk më kupton e dashur;
Mua më dhemb gjoksi
Si një mur i çarë oshtinë
Një gjëmë në brendinë time.

Lisat rrinë me degë të varura
Nga kujtesa e drurëve pikon rrëshira
Pikojnë...
Edhe pikëllimet e gjelbërimit
Një nga një bien në tokë
Gjethet e zverdhura të një stine.

Jashtë mureve të oborrit
Sërish nuk ndalen erërat
Po frynë disa stuhi të bezdisshme.
Stinët janë të ngarkuara
Me plotë pikëllim,
Mezi po presin
Që ky dimër të abortoj dhembjen.

NË SHPIRTIN E SOFRËS SË SHTËRZUAR

Sonte kryqi im asnjanës
E paska humbur rrugën,
Në ëndrrën e vet
E ka humbur
Dhe si i babëzituri troket
Nëpër të çarat e kujtimeve.

Në këtë darkë të fundit
Dikush po e hanë bukën e hidhur,
Pas shpinës së një njeriu
Gjuan me shikime vrastare.

Lugët e ndryshkura i tjerrin fjalët
E thëna dhe të pathëna,
Një dyshim rri pezull
Në ajrin e dylltë të mbrëmjes.

Shpirti i sofrës së shtërzuar
Hingëllon si pjatat e palara,
Një njeri
Sonte do udhëtoj diku larg.

Do udhëtoj aq larg
Sa që do kthehet pas dymijë vjetëve!
Do kthehet
I ngarkuar me të gjitha mëkatet njerëzore.

TË DEHURIT ME MALLËNGJIM KËNDOJNË

Kjo natë e ngarkuar me melankoli
Me xhelozi e shkund fustanin e hënës,
Në gjoksin e saj të vogël
I shoh të çarat e pashërueshme të ditës.

Nëpër ballin e rrudhosur të viteve
Rrjedhin lumenjtë e trentë,
Rrjedh një histori e tërë
Asgjë të re nuk ndodh në këto çaste.

Vetëm zëri i sëmurë i mështeknës
Së shartuar,
Dëgjohet si një uturimë mali
Pak më larg kajsishtave qajnë zogjtë.

Hëna si një drapër i ndryshkur
Pushon mbi qafën e një rrapi,
Yjet bredharak
Enden nëpër lagjet e evgjitëve.

Sonte këtu askush nuk qanë
Të dehurit,
Me mallëngjim këndojnë
Një elegji të vjetër qytetare.

NGA LARG DUKESHIN SI BRIRË DRERI

Në një mëngjes të hershëm
Pa i dëgjuar zërat e para të gjelave;
Fqinjët e mi braktisën shtëpinë
Dhe si lejlekët e verbër
E morën dynjanë në sy.

Një natë më parë
Nëna e madhe i shiti byzylykët,
Dhe unazën e heshtjes vajzërore
Ashtu në heshtje
Siç jetuan
Ikën në një mëngjes të hershëm.

Kurrë më asnjë letër nuk erdhi
Në adresën e vjetër
Të lagjes sonë,
Dyert e mbyllura me shtatë dryna
Nga larg dukeshin si brirë dreri.

Me vitet të tëra askush nuk trokiti
Në përmallimin e drurit,
Era lakuriqe për çdo mëngjes
Qante me qenin endacak të lagjes.
Qante me ngashërim
Tok me portat e mbyllura.

NUK MË LË KOT TË PRES KËTË DITË

Ëndrra ime ti çdo ditë
I zgjatë duart,
Majave të atij mali
Ngjanë me lejlekët e bardhë
Që sërish kthehen pas ëndrrave të tyre.

Ëndrra ime e vogël
Sa qenke me dëshira të mëdha,
Ende po i ëndërron
Mëngjeset e tua të përmbytura,
Dhe zogjtë e fëmijërisë që fluturuan
Me shpresa të thyera nëpër dhera të huaja.

Ëndrra ime e vogël me dëshira të mëdha
Nuk lë derë pa trokitur,
U bëre miq me armiqtë e përbetuar
Çdo gjë ribëre edhe të pamundurën
Veç ta shohësh të lirë atdheun.

Ëndrra ime e vogël me dëshira të mëdha
Më në fund arrite ta shijosh pemën
E fryteve të tua.
Ëndrra ime, shpresa ime e ujitur me vite
Të faleminderit
Nuk më lë kot të pres këtë ditë
Ëndrra ime e mirë.

BRENDA NESH RRITEMI EDHE NE

Brenda nesh
Diku në thellësitë e damarëve,
Jeton një burim i pashtershëm.
Jeton
Si një lëvizje e përhershme!..

Te ato lëvizje
Çdo gjë ndryshon dhe rritet mes nesh;
Herët pa gdhirë agullima
Gota e zbrazët si kurdoherë
Mbushet me aromë lulesh.

Brenda nesh rriten edhe shpresat
Që nuk njohin asnjë lloj të vdekjes,
Rriten ashtu siç rritet bari i gjelbër
Në syrin e kaltër të mëngjesit.

Brenda nesh rriten dëshirat e shpresat
Rriten edhe parathëniet e thëna,
Dhe ato që nuk u thanë asnjëherë
Brenda nesh rritemi edhe ne.

KY POET I MADH I VENDIT TIM

Kur i kam mbi tavolinën
Time të punës
Poezitë e poetit Rreshpja,
Më besoni miqtë e mi
Ndjehem shumë më mirë si njeri.

Më ledhaton një dorë engjëlli
Diçka e padukshme,
M'i lehtëson vuajtjet e jetës
Dhe shoh poetin Frederik
Si një gjigand
I cili kurrë nuk u gjunjëzua.

Ishte lisi që i përballoi furtunat
Më të çmendura të maleve të egra.
Lisi i një fisi,
Që s'i doli përballë asnjë Zot
Ta gjunjëzojë atë burrë të madh.

Eci si Krishti nëpër plagët e veta
Dhe vuajtjet e jetës,
Eci deri në asgjësim
Por kurrë nuk u gjunjëzua
Ky poet i madh i vendit tim.

PREJ PJESËS TËNDE TË VOGËL

Nëse në dorën tënde
Mban një gjysmë molle
Mos e ha vetë,
Shikoi sytë e erës
Se sa janë të uritura.

Jepja një pjesë
Prej pjesës tënde të vogël,
Ashti siç ta dhuron ty shiu
Shpirtin e padukshëm të ozonit.

Mbaj mend mos mbaj
As të ligën më të vogël
Vetëm për vete,
Ndaje me miqtë
Dhe mes miqve të njohur e të panjohur.

Secili le ta ketë
Një pjesë shumë të vockël,
Nga trishtimi yt
Në të kundërtën, mendo mirë se kush je?!

PASTAJ PA HUMBUR KOHË

Era pikturon në vjeshtë
Peizazhin e pikëlluar të stinës,
Kurse në dimër
Fundoset si varka e thyer
Në shpirtin e ngurtë të acarit.

Kur arrin të afrohet
Pranë buzëve të njoma të barit
Ulet këmbëkryq;
Ulet në krye të luadhit
Kuvendon me korin e bretkosave,
Si dhe me ndonjë karkalec
Që fërshëllen melodinë e shiut në pranverë.

Pastaj pa humbur kohë
Huazon nga ngjyrat e ylberit,
Spektrin imagjinar
E të gjitha llojeve të gjelbërimit,
Dhe me brushën e mishtë të erës
I shëron
Ngjyrat e zjarrta të rrezeve të hënës.

EDHE MËSHTEKNA E DEHUR KËNDON

Prapa këtyre perdeve të hirta
Kotet një pyll i dendur me lisa të përgjumur;
Një kor i tërë mbretëror
I vë në gjumë
Gjethet e këputura të trishtimit.

Një zog i vetmuar si mallkimi
I një njeriut të humbur,
Qan mbi një lis të pikëlluar
Qajnë edhe mjegullat
Fatin e shirave
Çdo gjë sonte ngjanë me lotët e erës.

Në brendinë zgërbonjës së lisit
Mëllenjat e kuqe,
Po e hedhin një valle të lashtë
Vallja e cila ngjan me perëndit pagane
Me shekuj i mbanë të kyçura
Yjet në qiell.

Sonte në këto çaste solemne
Edhe mështekna e dehur këndon,
Këndojnë gjethet një këngë arkaike
Për lashtësinë e rrënjëve
Që me padurim presin rritën e lumit.

NËPËR XHAMAT E KUJTESËS

Para sysh më shtrihen si dallgët
Imazhet asnjanëse të ngjyrave,
Një ylber i përhitur
Në ëndrrën e mbrëmshme
I kishte harruar të gjitha ngjyrat.

Një shi i çmendur imcak
Po troket sonte
Nëpër xhamat e kujtesës.
Po troket çmendurisht
Po troket
Në kornizën e harruar të mbrëmjes.

Shikoj përtej dritares
Shiu s'paska të ndalur sonte,
Një dorë e uruar
Pas qindra viteve
I zgjoi ullukët e fjetur.

Sërish shiu nuk ka të ndalur
Vrapon si i çmendur rrugëve të fëmijërisë;
Vrapon e nuk di të ndalet
Nga shpirti i ullukëve
Ka zënë e po pikon trishtimi.

SËRISH NJË VRAP I DEHUR

Vrapoj nëpër stuhi
Koha nuk mbaron,
Vrapoj ledheve të erës
Hapi im askund nuk përfundon.

Sërish një vrap i dehur
Nuk ndalet në asnjë sukë a bokë,
Vrapon njeriu deri në asgjësim
Vrapon nën ujë dhe vrapon mbi tokë.

Një vrap në hapësirë
Tjetri përfundon diku në horizont,
Ecën njerëzimi përpara vrapon
Si zogu i shenjtë nëpër qiell hulumton.

Prishtinë, 26 qershor 2014

ASNJË ZË NJERIU S'LËSHOJNË MURET

Në një kohë të ligë
Peizazhet e zhveshura deri në asht;
Nga barku i hidhur i tokës
Rilindin si pemët.

Shirat i ndryshojnë itineraret
Ngjajnë me trenat e çmendur,
Kanë dalë të rrugëtojnë
Por nuk dinë se për ku janë nisur.

Disa stërkala të vogla si mizat e kuqe
Ngjiten nëpër xhamat e mendimeve,
Në brendinë e dhomës rritet acari
Kurse jashtë mureve djersiten pemët.

Një flutur e verdhë troket
Çmendurisht troket në portat e erës,
Askush përtej atyre dyerve të rënda
Asnjë zë njeriu s'lëshojnë muret.

SA SHUMË NGJAJNË ME TË ZOTËT E SHTËPISË

Jam i zbrazët dhe i tejdukshëm sonte
Në këtë hapësirë lakuriqe,
Duart e mia prekin ajrin e acartë
I ngacmojnë gjymtyrët e mjegullave.

Jashtë mureve të shpirtit tim
Përpëlitet një sterrë e mërzitshme,
S'ka njeri të gjallë këtu
Askush nuk i hapë dyert e mbyllura.

Dryni i shurdhët me muaj po dënesë
Dënesin edhe parmakët e ndryshkur,
Ky shi i hidhur i kësaj vjeshte
Mbase nuk paska të ndalur.

Nëpër ullukët e çative të rrënuara
Ka kohë që nuk fluturojnë kanjushat,
Paskan ikur edhe këta zogj shtegtarë
Sa shumë ngjajnë me të zotët e shtëpisë.

DHE RIBËNIN NJERËZ PREJ PEMËVE

Deshën të më ribëjnë nga një copë deltine
Mendja ime qante si një kalama,
Nga pemën e fëmijërisë
Kanë zënë e po shkunden
Frytet e një tjetër stine të egër.

Çfarë nuk deshën të ribëjnë njerëzit
Nga duart e kallamishteve,
Çurgonte frika
Një zë i largët sërish qante në mua.

Prapa shine
Vrapuan disa kalorës të çmendur,
Prapa tyre si nëpër ëndrra të liga
Galopuan edhe kalldrëmet e zhveshura.

Atë ditë të bekuar
Hyjnorët kishin zbritur në tokë,
Për të ribërë njerëz
Prej degëve të pemëve shterpe.

Nga të gjitha anët e hapësirës
Shkrepnin vetëtimat,
Dhe nën hijet e plepave
Ua vënë flakën gurëve të murrmë.

As zjarret s’kanë të pushuar
Thua se po digjet Roma,
Disa piroman
Me nga një pishtar në dorë
Bredhin rrugëve qorre.

Bredhin me shpresa të pashpresë
Kinse do e ribëjnë një tjetër zjarr;
Për njerëzimin
Që ka mbetur peng hapave të mjegullave.

NËPËR PASQYRAT E DIMRAVE TË ACARTË

Për çdo ditë takoj njerëz
Të humbur si zogjtë
Drurë duke rendur pa itinerar.
Që ngjajnë me trenat e harruar
Nëpër stacione të braktisura.

Kalojnë rrugëve qorre
Duke ribërë prej ëndrrave duar lisash;
Ecin të shthurur si pemët
Kur i zë bryma marrin frymë ngadalë
Dhe bashkëjetojnë me shirat e myktë.

Kur takohen me vetveten
Nëpër pasqyrat e dimrave të acartë,
I gjejnë relievet e oksiduar nga lagështit
Dhe nga kornizat e të ftohtit
I zbresin në tokë ikonat e vetmuara.

PORTAT QË NUK HAPEN E AS NUK MBYLLEN

Kjo rrugë e gjatë
Ku njerëzit i shpalosin zarfet e kaltra;
Sa shumë po i përngjanë
Atyre rrugëve të lagshta të fëmijërisë.
Sa shumë po i përngjan
Letrave të shkruara netëve të vona.

Më duket se atëherë ishin
Disa kohëra të tjera,
Tepër të liga ku njerëzit
Për një fjalë goje zhdukeshin,
Nëpër rrugët e zeza
Që na qonin nëpër udhët qorre
Dhe asnjëherë më nuk na ktheheshin burrat.

Shtëpitë na mbeteshin të boshatisura
Të acarta,
Si dimrat e egër të Ballkanit
Ngjanin gogolëve të fushave.

Nuk kishte njeri që trokite në portat
Të cilat nuk hapeshin,
As nga brenda
E as nuk mbylleshin nga jashtë.

I kapërcyem të gjitha rrugët e zbrazëta
Edhe ne i përngjanim
Zbrazëtisë së errët,
Por nuk i ndalëm dot ecjet
Dhe sot në këtë moshë të tretë
Përjetojmë sinqerisht përjetojnë
Ribërjen tonë si njerëzit e tjerë.

Përtej muranave të kujtesës
Cikli i tretë

JASHTË MENDJES SË NJERIUT

Një sofër rrumbullakët
Me dymbëdhjetë lugë të drunjtë,
Njeriu dhe luga e trembëdhjetë
Gjuajnë gurë të verbër pas shpine.

Nën sofër si sterra mjaullinë
Një mace e egër,
Bludat gostitin një copë ashti të pazier
Nga tavani bien fijet e flokëve
Të merimangave të zeza.

Jashtë mendjes së njeriut
Furtuna thur një kurth të pabesisë;
Ti dy herë më përshëndete sot
Herën e tretë do e shikojmë
Vdekjen e hënës.

Sërish një njeri i urtë
U përballë me trishtimin e golgotës;
Kësaj radhe i ligu
Tradhtoi njeriun
Mbi kryqin e një fati zuri fill fatkeqësia
Një shi i çmendur nuk pushoi më.

Drita çmendurisht hyri
Nëpër portat e balsamosura,
Mbas dymijë vjetëve
Një diell i ri
Ndoshta do i këndoj psalmet
E pa kënduara deri më sot.

STRUKET PAS KRESHTAVE TË LARTA

Është një kohë e papërshtatshme
Dielli më nuk lind në Lindje,
Ka marrë një tjetër udhë
Mbrëmjeve të vona kthehet i lodhur.
Mbase as nuk i pëlqejnë
Udhëtimet e trajtave të gjata!

Kur zbresin dimrat nga malet
Rrallë herë duket në horizont,
Edhe atëherë kur paraqitet
Duket si kallkan me buzë të ngrira
Mëngjeseve herët
Vjen me një shall të zakonshëm.

Pastaj, dikur pas dite i heq këmbët zvarrë
Ashtu i lodhur dhe i ngrirë
Struket pas kreshtave të larta,
Dhe pret të nesërmen
Ose pranverën e hershme
E cila sivjet po kthehet më shumë vonesë.

MBËSHTETUR MBI SHPATULLAT E AJRIT

Pranë qepenave të shimshirët
Shoh njerëz të lodhur,
Qëndrojnë në një këmbë
Mbështetur mbi shpatullat e ajrit
Qëndrojnë
Duke i rrotulluar sytë e vegjël.

Kanë një memorie të jashtëzakonshme
Ajo është tinëzare,
Si hapat e erës
I përcjellin kalimtarët e rastit
Askush nuk u shpëton
Shikimeve të dyshimta të rrugicave.

Me orë të tëra përpiqen t'i regjistrojnë
Gjurmët e padukshme
Të kalimtarëve,
Dhe këtë e bëjnë më së miri
I njohin të gjitha llojet e zogjve
Vetëm zëri i hutinit
Ua shqetëson nga pak qetësinë.

POR DIÇKA ËSHTË E SIGURT

Pa ty për çdo ditë nga pak
Po fundosem në mjerimin tim,
Po fundosem
Si anijet e humbura në zbrazëtirën e detit.

Një hënë e zbehtë sonte po duket
Si një arkivol i mavijosur,
Nuk di a është ky udhëtimi im i parë
Ose ai i fundit për në ferr.

Por diçka është e sigurt,
Se diku pas shpine na pret e përtejmja
Ajo rrugë e gjatë e moskthimit
Që jeton me kryqin e trishtuar të njeriut.

Pa ty po ma ngufat frymëmarrjen
Kjo vjeshtë e bezdisshme,
Si t'i zgjas duart në këtë dimër të vonshëm
Kur dielli i ngrirë po m'i ngrinë eshtrat.

Kur zbret nga froni mbrëmja e përgjumur
E nis udhëtimin e saj,
Hipur mbi një varkë të imagjinatës
Udhëton deri në brigjet e kaltra të detit.
Edhe njerëzit këtu janë të kaltër
Të lodhur nga dielli përcllues
Struken pas ëndrrave
Duke pritur të nesërmen.

PA VETËDIJE I FSHEHIN SYTË

Udhëve të qytetit shoh njerëz
Që ecin me sy të zbrazët,
Kalojnë fshehurazi
Me nga një kapelë të shqyer në kokë.

Nën disa lloje të syzeve të errëta
Pa vetëdije i fshehin sytë,
Prej egos së turpëruar
Ose prej të tjerëve.

Njerëz pa emër dhe mbiemër
Shëtisin metropoleve të zbrazëta,
Shëtisin duke i fshehur në kujtesë
Letërnjoftimet pa adresë.

Secili prej këtyre njerëzve
Kanë nga një emër anonim,
Që nuk u duhet për asnjëherë në jetë
Ecin trotuareve të tejdukshëm
Me nga një valixhe prej kartoni.

Bredhin ngarkuar me dhembje
Përgjumen nëpër stacione të dehur,
Kohën e matin më orët e ndalura
Kur ndjejnë nevojën e pastrimit
I thërrasin të reshurat.

NËPËR DEGËT E THYERA TË YJEVE

Sonte gjërat po ndryshojnë kaq shumë
Asgjë nuk i përngjan imazheve të netëve,
Që na ikën në harresë.
Bie një mbrëmje e shurdhtë
Dhe të nesërmen
Ngrihet me tërë zhurmën e botës pikëllimi.

Para pak çasteve
Filluan këputjet e meteorëve,
Nëpër qiellin e vrarë kullojnë trishtimet
Një hënë e zbehtë kërcen si ketri
Nëpër degët e thyera të yjeve
Varen duart e meteorëve me bisht.

Askush sonte nuk e njeh vetveten
Njerëzit janë bërë të huaj,
Tepër të huaj për njëri - tjetrin
Aq të huaj
Sa që i kafshojnë mollët e kalbura
Ende pa rënë në tokë.

Farat e mykura si nëpër përralla
Po i lëshojnë rrënjët
Në parzmën e tokës së plagosur,
Ku çelin sytha
Filizat e para të një gjeneze.

PËRTEJ MUREVE TË KUJTESËS

Sa shumë ndryshojmë nga njëri-tjetri
Era paska një formë njeriu,
Në çdo lëvizje të saj
Vizatohet një hije e verdhë
Dhe portreti i shthurur i ditës.

Përtej mureve të kujtesës
Një dorë e huaj i shembi urat,
Trishtimet e netëve të thikave
Mbetën këndej lumit
Kurse ëndrrat e mia bëjnë vetëvrasje.

Sapo filluan edhe njëherë
Të kthehen sërish të reshurat
Sa shumë shi ra sivjet?!
Mbi flokët e ullukëve të zbardhur
Zhuri i ngopur me shpirtin e lumit
Po sheh do ëndrra të liga sivjet.

Po largohen edhe zogjtë
E fundit shtegtar,
Po largohen nëpër një itinerar asnjanës
Askush në këto çaste nuk di.
Se cila ëndërr do paraqitet sonte
Nga prapaskena e sterrës.

TË NJË FUNDI TË PIKËLLUAR

Nëpër rrugët e qytetit
Shoh njerëz dhe kuaj të lodhur,
Shoh se si kalamenden
Të dehurit nëpër bankinat e përgjumura.

Netët këtu janë të gjata
Kur zbrazen gotat e imagjinuara,
Deri në fund
Të një fundi të pikëlluar.

Hiç më pak se trishtimi
Zgjaten edhe duart e njoma të pemëve,
Nga ana veriore e qytetit frynë
Një përfëllizë e egër.

Lumi i çmendur nuk e ndalë gjëmën
Guralecët e verdhë,
Ngjajnë me peshqit e verbët
Dimrat këtu janë të paparashikueshëm.

Asnjëherë njerëzit nuk kuptuan
Se kah i bie veriu,
E kah jugu ku zgjohen
Nga gjumi perëndit e mermertë.

Orientimet në këtë qytet
Sa ora ndryshojnë kahet
I përngjajnë trekëndëshve;
Me katete të lakuara
Dhe asnjëherë
Nuk qëndrojnë në këmbët e veta.

I ZBRAZËT PA ASNJË ËNDËRR

Sot është e shtunë
Mund të mos hash bukë deri të mërkurën;
Por mos e lë jetën të kaloj
Nëpër zbrazëtirat e ecjeve të kaltra.

Nëse nuk shkon pas ëndrrave tua
Nuk di
Se nëpër të cilat udhë!?
Përfundon fati yt,
I zbrazët pa asnjë ëndërr.

Secili njeri
Ka nga një pëllumb të bardhë;
Në shpirt që i përngjan ëndrrës
Dhe është një pjesë e pandashme
E ecejakeve të tija.

Sa herë që vrapova si fëmijë
Pas ëndrrave të mia,
Përherë i takoja
Në kthesën e parë të jetës
Që më përqafonte me duar të hapura.

ASKUSH NUK I SHTRIU DUART E SHPRESËS

Ishte tepër vonë
Kur filluan të çelin zogjtë.
Një flutur digjej rreth qiriut
Hëna i kishte lidhur duart për gjoksi,
Dhe ndjehej
Tepër e dobët për ndërhyrje.

E flutura e shkrumbuar
Mezi i nxirrte këmbët,
Nga ajo flakë
Që s'pushonte së djeguri.

Askush nuk i shtriu duart e shpresës
Flutura dukej në pasqyrë,
Si një zog i humbur
Në gjoksin e plagosur të qiellit.

Thonë se ishte koha
E zjarreve të çmendura!
Digjej qielli dhe guri,
Drurët kishin rënë në dy gjunjë
Dhe luteshin perëndive të tyre
Mbase as nuk kishin se kujt t'i luten.

Nga ky zjarr i pashpirt
Kishin ikur edhe perëndit;
Asnjë njeri s'kishte mbetur në qytet
Përveç flakës së verdhë.

Era pabesisht lëpinte lëkurën
E shkrumbuar të ajrit,
Mbi krahët e djegura të fluturës
Trishtueshëm qante nata.

NJOH DISA NJERËZ

Njoh disa njerëz që kanë besuar
Se kurrë s'do të plaken,
Sot ata të mjerët
Mbledhin nëpër fusha kallamesh
Hirin e ditëve të tyre.

Ecnin nëpër një zjarr të verdhë
Dukeshin si perëndi të egër,
Nga sytë e tyre
Pikonte rrëshira e urrejtjes.
Kurse sot,
As hundët nuk munden me i fshi.

Njoh disa njerëz mendje shkurtër
Që na shikonin prej yjeve,
Kalonin rrugëve të qytetit
Si vetëtima.
Me automjete të blinduara
Kalonin si kuajt e paçjerrë të errësirës.

Njoh disa njerëz të shthurur
Që e ndërronin emrin,
Dhe mbiemrin e fisit të tyre
Aq shumë ishin dhënë pas pekuleve
Sa që harronin
Se kishin qenë dikur njerëz.

AKOMA PO AJO DERË E VJETËR

Asgjë nuk paska ndryshuar në dhomën time
Mbi tavolinë dënesin poezitë e pabotuara..!
Një kukull e motrës,
Ende i paska të përlotura sytë
Po qanë me një mallëngjim të pashuar
Për fustanin e shqyer.

Dritaret po me ato xhama të errëta
Që i patën vendosur pleqtë,
Të mos e shohim komshiun
Nëpër oborr.

Ndoshta ishin kohërat
Nga pak të shthurura nga mendja,
Por ishin kohërat
Kur duhej që ne t'i respektonim
Fjalën e shenjtë të burrave.

Akoma po ajo derë e vjetër
Me dry të rëndë
Dhe me doreza të ndryshkura.
Na dukeshin si bri dhish
Një llambë e vjetër,
Ndoshta duhet ta dërgojmë në muze
I cili qëndron përballë raftit.
Ku varte nëna ime ikonën e Shën Mërisë

Edhe disa gjëra të pavlera
Sillen përreth këmbëve tona,
Dhe nëpër skutat
E dhomës së vjetër
Ku qante dhe këndonte
Fëmijëria ime.

Por janë shumë të vlefshme
Ato cikërrime,
I duamë pamasë
Sepse na shoqëronin
Në skamjen tonë kur buka na dukej
Si libri i shenjtë.

ASHTU SIÇ I ZGJOJMË NE SOT

Më kujtohet kur na pate thënë
Se trëndafilat nuk mbinë përherë,
Në gjoksin tënd
Lulet i çelin dhe i mbyllin petalet
Vetëm kur u vjen atyre koha.

Tani çdo fjalë tënde e kam të qartë
Po i kuptoj parathëniet
E çasteve që na ikën..!

Dhe ti pate të drejtë atëherë
Kur na mësoje;
Mënyrën e çeljes së luleve.
Kurse ne ishim fëmijë naiv
S'dinim as të besojmë.

Tashmë është tepër vonë
Ti qeshje me mosbesimin tonë;
Dhe i zgjoje kujtimet e tua
Të kahershme.

I zgjoje
Ashtu siç i zgjojmë ne sot,
Lulet e fjetura
Dimri veç ka filluar
Me i shkund pemët e njoma.

DHE KARTOLINA TË USHTARËVE DEZERTORË

Në shëtitoren e vogël të qytetit
Gati për çdo ditë
Ndalen tregtarët klandestin.

Çfarë nuk shesin
Prej dhëmbëve artificialë,
Deri te karficat e fildishta
Dhe kartolina të ushtarëve dezertorë.

Kur bie nata
Zbrazen dhe mbushen gotat me grindje;
Dehen edhe kuajt
E këtyre shitësve të rrugëve.

Një mandolinë e vetmuar
Dëgjohet diku larg,
Nën ndonjë ballkon
Nuk ndalen as fërshëllimat e yjeve.

Të nesërmen harrohen
Ngjarjet e pamira,
Shitësit dhe stërshitësit
Veç i kanë ndërruar maskat.

Secili duket me një buzëqeshje tjetër
Mall të vjedhur dhe kontrabandë,
Kurdoherë gjen
Në shëtitoren e vogël të qytetit tim.

Prishtinë,28 qershor 2014

Adem Zaplluzha u lind në Prizren, më 1943. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990,* nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.
15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.

16. **“Bajraktarët e vatanit”,** poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010

31**. ”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010
32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012

47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12
48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012

63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012
64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 **“ Ky def prej hëne”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012

78**.“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 **“ Fërfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80**. “Refrene yjesh”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. **“Te delta e mjellmave”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.**“Rinjohja”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83**.“Diku në fund të një fillimi”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84**.“Makthi i hijes”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.**“Një zog prej uji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot,2013
86**.”Asnjë fjalë nuk frymon”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87**.”Daullet e një nate”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014
88**.”Sytë e gurtë të erës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
89**.”Kur dehen perënditë”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
90. **“Fjetëm njëqind shekuj”** Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot ,2014
91**.”Krakëllimat e natës”,**Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
92. **“Ndjekësit e enigmave”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014

93. **“Atdheu i paçmuar**”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
94**.”Psalm i harruar ”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”**Për që po bie moj kambanë**”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
96. **“Mbi flokët e ullukëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. **“Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e** Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98**. “Loti i gotës së dehur”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99**. ” Stina asnjanëse”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. **“Dëneste bashkë me erën”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. **“Druri i pikëlluar**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
102. **“ Një grusht dashuri”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
103. **“Lëreni zërin tim”** , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
104. **“Shi në qytetin tim”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
105. **. “Si trenat e verbër ” ,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
106. **“Zjarri i malli tim ”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
107 **. “Kur teshtinë era** ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014

108. “Mbi shpirtin e erës pagane ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
110”**Ajo nuk erdhi sonte”** Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
112. “**Nëpër plasaritjet e mureve”,**Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
113.“Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”,Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
116”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015

PËRMBAJTJA

Fluturojnë zogjtë e verbër
Cikli i parë

Dimri sivjet ishte tepër i acartë 15
Ta ndjejmë ekzistencën e fjalës 16
2. 17
Këto motra binjake të lëvizjeve 18
Sonte po bënë shumë acar 19
Të lutem më shkruaj një letër 20
Kur të pushojnë të reshurat 22
Përtej gjelbërimit të bregut 23
Jashtë po frynë një acar i zi 24
Hapen edhe dyert e mbyllura 25
Njëherë në maje të një plepi 26
Për një vrap të tillë 27
Edhe të dielën në ora shtatë 28
Rrinë ulur perënditë paganë 29
Bëjnë dasmë netëve të vona 30
E mos ardhshin më asnjëherë 32
Bëhu i urtë biri im 33
Për të mos vdekur askurrë 34
Fluturimet e zogjve të hekurt 35
Aq shumë ndriçojnë sytë e tu 36
Fluturojnë zogjtë e verbër 37
Dhe u rritëm si lisat në stuhi 38

Brenda nesh rritemi edhe ne
Cikli i dytë

Veriu doli nga binarët e verbër 43
Lumi në ekstazë i kishte përpirë 44
Të çarat e ngrira i shtrinë duart 45
Prej të burgosurve anonim 46
Loja 47
Mbante nën sqetull hijen e vdekjes 48
2. 49
3. 50
Sa që në pasqyre nuk e njohin vetveten 51
Ngjajnë me lejlekët e bardhë 52
Sërish nuk ndalen erërat 53
Në shpirtin e sofrës së shtërzuar 54
Të dehurit me mallëngjim këndojnë 56
Nga larg dukeshin si brirë dreri 57
Nuk më lë kot ta pres këtë ditë 58
Brenda nesh rritemi edhe ne 59
Ky poet i madh i vendit tim 60
Prej pjesës tënde të vogël 61
Pastaj pa humbur kohë 62
Edhe mështekna e dehur këndon 63
Nëpër xhamat e kujtesës 64
Sërish një vrap i dehur 65
Asnjë zë njeriu s'lëshojnë muret 66
Sa shumë ngjajnë me të zotët e shtëpisë 67
Dhe ribënin njerëz prej pemëve 68
Nëpër pasqyrat e dimrave të acartë 70
Portat që nuk hapen e as nuk mbyllen 71

Përtej muranave të kujtesës
Cikli i tretë

Jashtë mendjes së njeriut 75
Struket pas kreshtave të larta 77
Mbështetur mbi shpatullat e ajrit 78
Por diçka është e sigurt 79
Pa vetëdije fshihen sytë 81
Nëpër degët e thyera të yjeve 82
Përtej muranave të kujtesës 83
Të një fundi të pikëlluar 84
I zbrazët pa asnjë ëndërr 86
Askush nuk i shtriu duart e shpresës 87
Njoh disa njerëz 89
Akoma po ajo derë e vjetër 90
Ashtu siç iu zgjojmë ne sot 92
Dhe kartolina të ushtarëve dezertor 93

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Fluturojnë zogjtë e verbër / Adem Zaplluzha. – Prishtinë : Trend, 2015. – 108 f. ; 21 cm.

[Shënime për autorin] : f. 95-104

ISBN 978-9951-694-05-6